

VENDIM
Nr. 603, datë 5.9.2012

**PËR DHËNIEN E LICENCËS PËR HAPJEN E INSTITUCIONIT ARSIMOR PRIVAT
PARAUNIVERSITAR, SHKOLLË FILLORE “DON ALFONS TRACKI”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 42 të ligjit nr. 69/2012, datë 21.6.2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Dhënie e licencës për hapjen, në komunën Velipojë, të institucionit arsimor privat parauniversitar, shkollë fillore “Don Alfons Tracki”, që do të përfshijë në programin mësimor edhe lëndë fetare dhe do të administrohet nga famullia Shën Nikolla, Velipojë.

2. Ngarkohet Ministria e Arsimit dhe Shkencës për ndjekjen e zbatimit të dispozitave ligjore e nënligjore për arsimimin, edukimin dhe formimin në këtë institucion.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha